



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 235

Tiranë – E mërkurë, 30 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 28.12.2015	Për disa ndryshime në ligjin nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar..... 16157
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1083, datë 28.12.2015	Për shpërblimin dhe kompensimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit..... 16160



AKT NORMATIV
Nr. 3, datë 28.12.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.
160/2014, “PËR BUXHETIN E VITIT
2015”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2015 është:

1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror
Të ardhurat, gjithsej 102 115 milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet	59 118	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	35 822	milionë lekë;
- përdorimi i gjendjes nga viti 2014	6 000	milionë lekë;
- transferim për shpërblime të pensionistëve	1 175	milionë lekë;
Shpenzimet	102 115	milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshon sa herë që rriten pagat dhe pensionet. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe për kategoritë e veçanta të personave të vetëpunësuar, duke mbuluar nga buxheti i shtetit diferencën midis këtyre kontributeve me masën e kontributit të përcaktuar për personat e vetëpunësuar në qytet. Për vitin 2015, teprica ndërmjet të ardhurave dhe

shpenzimeve sipas degëve të sigurimit shoqëror dhe programeve të tjera të veçanta e suplementare përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej 5 571 milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet	770	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	4 738	milionë lekë;
- transferim për shpërblime të pensionistëve	63	milionë lekë;
Shpenzimet	5 571	milionë lekë.

Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 044 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.”.

Neni 2

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

a) Shpenzimet sipas grupeve kryesore ndryshojnë:

“Shpenzimet e buxhetit qendror bëhen 344 733 milionë lekë”;

“Huadhënia për energjinë bëhet 2 000 milionë lekë”, dhe shtohen fjalët: “... nga e cila 1 000 milionë lekë jepet hua në formën e transfertës.”.

b) Tabela nr. 1, e përmendur në këtë nen, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij akti.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



AKTI NORMATIV 2015 (dhjetor II) - SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE
Viti 2015

Kodi	Emertimi i institucionit / programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
1	Presidenca	171,700	11,000	0	11,000	182,700
01120	Veprimtaria e Presidentit	171,700	11,000	0	11,000	182,700
2	Kuvendi	885,900	67,220	0	67,220	953,120
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	269,000	67,220	0	67,220	336,220
01120	Veprimtaria Ligjvënëse	616,900	0	0	0	616,900
3	Kryeministria	515,125	100,000	0	100,000	615,125
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	515,125	100,000	0	100,000	615,125
4	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	844,599	212,707	379,869	592,576	1,437,175
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	252,665	33,653	19,869	53,522	306,187
04130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	242,985	117,936	350,000	467,936	710,921
04160	Mbështetje për Mbiqë e Tregut, Infrast. e Gëjes. dhe Pron. Industr.	212,052	49,182	10,000	59,182	271,234
04760	Zhvillimi i Turizmit	136,897	11,936	0	11,936	148,833
5	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave	4,900,553	1,302,917	2,053,574	3,356,491	8,257,044
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	227,500	11,000	0	11,000	238,500
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,341,610	140,110	157,971	298,081	1,639,691
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	974,850	954,500	660,000	1,614,500	2,589,350
04250	Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq. Blek, Agroind dhe Market.	1,943,860	96,153	795,208	891,361	2,835,221
04860	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	211,900	48,000	0	48,000	259,900
05470	Menaxhimi qendruarshëm i tokës bujqësore	22,000	4,000	0	4,000	26,000
04230	Mbështetje për Peshkimin	81,600	28,000	359,000	387,000	468,600
05640	Administrimi i Ujërave	97,233	21,154	81,395	102,549	199,782
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	2,709,595	19,379,599	14,307,028	33,686,627	36,396,222
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	360,160	13,977	110,000	123,977	484,137
04520	Transporti rrugor	1,309,144	14,912,230	5,672,756	20,584,986	21,894,130
04530	Mbështetje për Studime në Transport	19,430	1,000	0	1,000	20,430
04540	Transporti Detar	73,253	330,000	250,000	580,000	653,253
04550	Transporti Hekurrudhor	456,997	150,000	175,000	325,000	781,997
04560	Transporti Ajror	12,111	5,000	0	5,000	17,111
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	478,500	3,913,986	7,799,272	11,713,258	12,191,758
06220	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	0	53,406	300,000	353,406	353,406
10	Ministria e Financave	6,685,441	267,387	130,639	398,026	7,083,467
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	248,330	108,280	76,000	184,280	432,610
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	457,299	10,000	0	10,000	467,299
01130	Ekzekutimi i Pagesave të Ndryshme	1,510,522	0	0	0	1,510,522
01140	Menaxhimi i të Ardhurave Tatimore	2,177,640	68,631	0	68,631	2,246,271
01150	Menaxhimi i të Ardhurave Doganore	2,208,320	66,476	54,639	121,115	2,329,435
01160	Lufta kundër Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	83,330	14,000	0	14,000	97,330
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	36,740,480	2,335,500	395,000	2,730,500	39,470,980
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	648,230	72,500	0	72,500	720,730
09120	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	22,862,920	1,354,708	0	1,354,708	24,217,628
09230	Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)	6,041,971	437,292	180,000	617,292	6,659,263
09450	Arsimi Universitar	5,345,590	348,000	215,000	563,000	5,908,590
09770	Fonde për Shkencën	177,000	0	0	0	177,000
08140	Zhvillimi i Sportit	1,664,769	123,000	0	123,000	1,787,769
12	Ministria e Kulturës	1,267,160	257,403	10,000	267,403	1,534,563
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	127,966	40,000	0	40,000	167,966
08220	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete	400,146	123,083	10,000	133,083	533,229
08230	Arti dhe Kultura	739,048	94,320	0	94,320	833,368
13	Ministria e Shëndetësisë	29,849,900	1,403,519	875,063	2,278,582	32,128,482
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	219,000	11,015	0	11,015	230,015
07220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	8,932,000	221,830	133,880	355,710	9,287,710
07330	Sherbimet e Kujdesit Dëtor	17,860,236	1,104,984	741,183	1,846,167	19,706,403
07450	Sherbimet e Shëndetit Publik	2,645,900	33,990	0	33,990	2,679,890
07460	Sherbimi Kombëtar i Urgjencës	192,764	31,700	0	31,700	224,464
14	Ministria e Drejtësisë	5,685,671	825,500	500,000	1,325,500	7,011,171
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	352,890	793,630	500,000	1,293,630	1,646,520
01120	Publikimet Zyrtare	45,926	200	0	200	46,126
01130	Mjekësia Ligjore	50,500	12,000	0	12,000	62,500
03440	Sistemi i Burgjeve	4,383,136	18,000	0	18,000	4,401,136
03350	Sherbimi i Përmbarimit Gjyqësor	103,800	1,000	0	1,000	104,800
01160	Sherbimet për çështjet e biresimeve	13,002	200	0	200	13,202
01180	Sherbimi i Kthimit dhe Komensimit të Pronave	580,247	470	0	470	580,717
03490	Sherbimi i Proves	156,170	0	0	0	156,170
15	Ministria e Punëve të Jashtme	2,214,047	63,600	0	63,600	2,277,647
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	94,140	54,600	0	54,600	148,740
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	1,925,887	9,000	0	9,000	1,934,887
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPI	194,020	0	0	0	194,020
16	Ministria e Brendshme	17,748,943	1,293,138	170,000	1,463,138	19,212,081
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	939,310	230,256	0	230,256	1,169,566
03140	Policia e Shtetit	13,395,388	753,000	170,000	923,000	14,318,388
03150	Garda e Republikës	1,249,605	47,471	0	47,471	1,297,076
01160	Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara të Pushtetit Vendor	535,640	8,442	0	8,442	544,082
01170	Sherbimi i Gjendjes Civile	746,000	244,000	0	244,000	990,000
01180	Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	104,000	9,969	0	9,969	113,969



10910	Emergjencat Civile	779,000	0	0	0	779,000
17	Ministria e Mbrojtjes	10,391,140	1,699,766	0	1,699,766	12,090,906
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,084,000	79,800	0	79,800	1,163,800
02120	Forcat e Luftimit	4,170,505	1,484,167	0	1,484,167	5,654,672
09430	Arsimi Ushtarak	541,600	0	0	0	541,600
02150	Mbeshetja e Luftimit	4,595,035	135,799	0	135,799	4,730,834
18	Sherbimi Informativ Shtetëror	1,312,200	50,000	0	50,000	1,362,200
03520	Veprimtaria Informativ Shtetërore	1,312,200	50,000	0	50,000	1,362,200
19	Drejtoria e Radio Televizionit	357,000	0	0	0	357,000
08310	Sherbimet për shpërndarje të kufirit	240,000	0	0	0	240,000
08520	Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	0	0	0	0	0
08330	Prodime filmike ose veprimtari artistike mbarekombetare	62,000	0	0	0	62,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH dhe Kinematografisë	55,000	0	0	0	55,000
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	158,700	5,000	0	5,000	163,700
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	158,700	5,000	0	5,000	163,700
22	Akademia e Shkencës	89,027	2,900	0	2,900	91,927
01520	Veprimtaria Akademike	89,027	2,900	0	2,900	91,927
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	330,000	20,000	0	20,000	350,000
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH	330,000	20,000	0	20,000	350,000
25	Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise	70,322,570	294,440	70,312	364,752	70,687,322
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	146,100	28,400	0	28,400	174,500
10220	Sigurimi Shoqëror	41,798,000	0	0	0	41,798,000
10430	Perkujdesi Social	22,795,500	40,662	40,312	80,974	22,876,474
10550	Tregu i Punës	1,812,000	43,472	0	43,472	1,855,472
04170	Inspektimi në Punë	169,500	14,710	0	14,710	184,210
10460	Perfshirja Sociale	53,500	30,341	0	30,341	83,841
08480	Mbeshetjet për Kultet Fetare	218,400	141	0	141	218,541
01190	Rehabilitimi i të Përdëkturve Politik	2,032,000	4,236	0	4,236	2,036,236
09240	Arsimi i Mesëm (profesional)	1,297,570	132,478	30,000	162,478	1,460,048
26	Ministria e Mjedisit	1,050,167	857,415	276,987	1,134,402	2,184,569
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	172,264	18,000	0	18,000	190,264
05320	Programe për mbrojtjen e Mjedisit	381,996	627,752	228,987	856,739	1,238,735
04260	Administrimi i Pyjeve	495,907	211,663	48,000	259,663	755,570
28	Prokuroria e Përgjithshme	1,411,837	135,000	0	135,000	1,546,837
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,411,837	135,000	0	135,000	1,546,837
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqësor	1,864,640	206,379	0	206,379	2,071,019
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	25,550	347	0	347	25,897
03310	Buxheti Gjyqësor	1,839,090	206,032	0	206,032	2,045,122
30	Gjykata Kushtetuese	105,560	12,000	0	12,000	117,560
03320	Veprimtaria Gjyqësore Kushtetuese	105,560	12,000	0	12,000	117,560
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	63,200	1,000	0	1,000	64,200
08320	Veprimtaria Telegrafike e ATSH-se	63,200	1,000	0	1,000	64,200
40	Partitë Politike	200,000	0	0	0	200,000
01110	Mbeshetjet për Partitë Politike	190,000	0	0	0	190,000
01120	Mbeshetjet për Shoqatat	8,000	0	0	0	8,000
01130	Mbeshetjet për Organizatat e Veteranëve me Status	2,000	0	0	0	2,000
50	Instituti Statistikës	361,230	23,192	0	23,192	384,422
01320	Veprimtaria Statistike	361,230	23,192	0	23,192	384,422
55	Shkolla e Magjistratës	57,000	3,500	0	3,500	60,500
09820	Veprimtaria Arsimore	57,000	3,500	0	3,500	60,500
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	1,350,000	5,200,000	6,550,000	6,550,000
06210	Programe Zhvillimi	0	1,350,000	5,200,000	6,550,000	6,550,000
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	139,170	2,360	0	2,360	141,530
08220	Mbeshetja e veprimtarisë kinematografike	139,170	2,360	0	2,360	141,530
63	Keshilli i Lartë i Drejtësisë	73,140	2,000	0	2,000	75,140
03320	Veprimtaria mbikqyrese e KLD	73,140	2,000	0	2,000	75,140
66	Avokati i Popullit	91,500	4,000	0	4,000	95,500
03320	Sherbimi i avokatise	91,500	4,000	0	4,000	95,500
67	Komisioneri për Mbrojtjen e Sherbimit Civil	46,470	7,000	0	7,000	53,470
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	46,470	7,000	0	7,000	53,470
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	683,304	8,000	0	8,000	691,304
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	83,304	8,000	0	8,000	91,304
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	600,000	0	0	0	600,000
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	91,520	16,280	0	16,280	107,800
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	91,520	16,280	0	16,280	107,800
77	Autoriteti i Konkurrencës	62,840	1,000	0	1,000	63,840
04120	Mbikqyrja e tregut & Garantimi i konkurrencës	62,840	1,000	0	1,000	63,840
78	Ministria e Integritetit	147,000	80,350	258,056	338,406	485,406
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	53,700	35,372	0	35,372	89,072
01140	Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm	26,500	0	0	0	26,500
01150	Mbeshetja Institucionale për Procesin e Integritetit	66,800	44,978	258,056	303,034	369,834
82	Keshilli Kombëtar i Kontabilitetit	9,310	1,000	0	1,000	10,310
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	9,310	1,000	0	1,000	10,310
87	Institucione të tjera Qeveritare	1,354,824	481,200	1,000	482,200	1,837,024
01320	Sherbime Qeveritare	90,000	16,500	0	16,500	106,500
01130	Sherbimi i Prokurimit Publik	67,840	7,000	0	7,000	74,840
01140	Sherbime për Shërbime dhe Informacionit	874,936	334,700	0	334,700	1,209,636
01150	Sherbime të tjera	106,203	41,000	0	41,000	147,203
01510	Sherbime për Teknologjinë dhe Inovacionin	20,900	77,000	0	77,000	97,900
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administratës Publike	137,025	5,000	0	5,000	142,025



01160	Shqipëria Dixhitale	57,920	0	1,000	1,000	58,920
88	Mbeshetjet për Shoqërië Civile	119,500	1,000	0	1,000	120,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	119,500	1,000	0	1,000	120,500
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	53,800	15,500	0	15,500	69,300
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	53,800	15,500	0	15,500	69,300
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	36,500	1,000	0	1,000	37,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	36,500	1,000	0	1,000	37,500
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	26,000	1,000	0	1,000	27,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	26,000	1,000	0	1,000	27,000
93	Ministria e Energjië dhe Industrisë	605,030	1,676,744	182,045	1,858,789	2,463,819
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	218,990	1,162,855	33,613	1,196,468	1,415,458
04320	Mbeshetjet për Energjië	9,000	108,675	115,432	224,107	233,107
04430	Mbeshetjet për Burimet Natyrore	159,500	324,250	33,000	357,250	516,750
04440	Mbeshetjet për mbikëqyrjen e standarteve teknike të hidrokarbureve dhe minierave	217,540	80,964	0	80,964	298,504
94	Ministria e Zhvillimit Urban	1,056,162	600,326	341,272	941,598	1,997,760
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	174,476	55,220	0	55,220	229,696
06180	Planifikimi Urban dhe Strehimi	881,686	545,106	341,272	886,378	1,768,064
TOTALI		202,889,455	35,078,842	25,150,845	60,229,687	263,119,142

VENDIM**Nr. 1083, datë 28.12.2015**

**PËR SHPËRBLIMIN DHE
KOMPENSIMIN E DISA KATEGORIVE
TË VEÇANTA PËR FESTAT E
FUNDVITIT**

Në mbeshetjet të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në sistemin e arsimit publik jepen shpërblime për kategoritë e mëposhtme:

a) Për 500 mësuesit më të spikatur jepet shpërblimi, në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë.

b) Për nxënësit e shkëlqyer në ciklin e dytë të sistemit të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm jepet shpërblimi prej 5 000 (pesë mijë) lekësh.

c) Për studentët e ekselencës në sistemin e arsimit të lartë jepet shpërblimi prej 5 000 (pesë mijë) lekësh.

Efektet financiare përballohen nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, miratuar për vitin 2015.

2. Për 300 mjekët më të spikatur jepet shpërblimi, në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë. Efekti financiar përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, miratuar për vitin 2015.

3. Përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë përfitojnë kompensimin financiar në masën 2 000 (dy mijë) lekë, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

Faqe | 16160

a) Familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike;

b) Familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”;

c) Individët përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;

ç) Individët përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar.

Efektet financiare përballohen nga zëri “Ndihma ekonomike dhe pagesa e paaftësisë”, miratuar në buxhetin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për vitin 2015.

4. Pensionistët përfitojnë kompensimin financiar, në masën 2 000 (dy mijë) lekë, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat, që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b) Personat, që marrin pension, sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c) Personat, që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë



punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, dhe personat, që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar.

ç) Personat, që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe personat që marrin pension sipas

ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2015 për skemën e sigurimeve shoqërore në buxhetin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe ministrinë e institucionet e përmendura në këtë vendim për detajimin e fondeve sipas strukturës përkatëse buxhetore dhe përcaktimin e procedurës së dhënies së shpërblimeve dhe të kompensimit financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 56 lekë